



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

03 Mars, 2023

Prishtinë

Me anë të kësaj shkrese po përcjellim komentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me raportet konsultative për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM).

Nga raporti, vërehet se është marrë parasysh edhe ndarja e 24.6 milionë eurove për subvencionim të tarifave nga ana e Qeverisë, mirëpo nuk është e qartë nëse janë marrë parasysh edhe Vendimet 01/117 dhe 02/117 të Qeverisë për mbështetjen e sektorit të energjisë elektrike me ndarjen edhe të 20 milionë eurove tjera shtesë dhe masa në të cilën janë shpenzuar dhe parashihen të shpenzohen gjatë javëve në vijim.

Marrë parasysh sqarimin potencial për ndarjet e paraqitura më sipër, e shohim të nevojshme të theksojmë edhe çështjet në vijim:

Caku i pandryshuar i humbjeve për OSSh: Për vitin e ri tarifor, caku i humbjeve të lejuara ka mbetur i pandryshuar për vitin 2023, ndërsa ndryshon vetëm 0.4 pikë përqindjeje për vitin 2024, kjo përkundër faktit që OSSh ka për detyrim zvogëlimin e humbjeve, dhe për këtë i njihen edhe investime të lejuara në vlerë prej 28.6 milionë euro për vitin 2023 dhe 37.7 milionë euro për vitin 2024. Me fjalë tjera, konsumatori detyrohet të paguajë për investimet e reja në rrjet, mirëpo nuk i mundësohet të përfitojë asgjë nga reduktimet e humbjeve që rezultojnë nga ato investime. Ju si rregullator do duhej të siguroheshit që të mos krijohen këso raporte asimetrike në mes të palëve, ku konsumatori paguan dy herë – edhe investimet, edhe humbjet e lejuara. Gjithashtu, nuk kishte sqarime të mjaftueshme se çka nënkuptoni me faktorin për ndarjen e humbjeve 50/50 për vitin 2023.

Heqja e konsumit të pjesës veriore të vendit nga përlllogaritja e humbjeve të lejuara për OSSh: Këtë çështje e kanë ngritur edhe në komentet e kaluara MFPT. E ritheksojmë edhe njëherë për vëmendjen tuaj, ashtu që gjatë përlllogaritjes së humbjeve të lejuara të cilat detyrohen të paguajnë konsumatorët, në bazën e nivelit të konsumit të mos përfshihet edhe sasia e humbjeve në pjesën veriore të vendit. Kjo e fryn nivelin e kostos së humbjeve të lejuara për rreth 57 GWh apo rreth 4.9 milionë euro në vlerë monetare.

Mbulimi i hendekut për HLM për 2023 të bëhet kryesisht nga bizneset: Në shqyrtimin e ndodhur vitin e kaluar, përkundër propozimeve nga MFPT por edhe nga palë tjera siç është Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, ZRRE la të pandryshuara tarifatat për bizneset, duke ndryshuar vetëm

tarifat për amvisëritë me shtimin e bllokut të ri tarifor për konsumin mbi 800 kWh. Nisur nga kjo situatë, për vitin 2023, sugjerojmë që tarifat për amvisëritë do të mbeten të pandryshuara, ndërsa mbulimi i hendekut të bëhet (në masë të madhe) duke përshtatur tarifat për bizneset, dhe sidomos bizneset e mëdha. Një përshtatje e tillë për bizneset e mëdha mund të shihet edhe në kontekstin e hapjes së tregut, ku tarifat e rregulluara do duhej që gradualisht të konvergjonin me tarifat që aktualisht janë në treg të hapur.

Tutje, në faqen 9 të raportit ku tregohet për çmimin e importit për MWh dhe si referencë është EEX – PXE Hungarian Power Futures, duhet të sqarohet edhe lakorja e çmimeve se si ka ardhur deri tek vlera e përvetësuar prej 171.5 Euro/MWh (tabela 3).

Në tabelën 5, Kostot e Bartshme – Kostot për Fondin e BRE, kërkesa e FSHU-së për vitin 2023 është 3.77 milionë euro ndërsa propozimi i ZRRE-së është 12.37 milionë euro. Duhet të sqarohet qartë se si është arritur deri tek ky propozim.

Në faqen 2 paraqitet një gabim teknik ku periudha tarifore është data “1 prill – 31 mars 2023” kurse duhet të jetë “1 prill 2023 – 31 mars 2024”.